



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 8.9.2021

- Lënda:** Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Shkëlqim Miri
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në seancën gjyqësore të datës 21.7.2021, lidhur me ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 374, datë 23.4.2021, ndër të tjera, vendosi t’i japë fund hetimit gjyqësor dhe ftoi Komisionerin Publik të paraqesë konkluzionet përfundimtare.

Komisioneri Publik, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e paraqitur dhe parashtrimeve të seancës së datës 21.7.2021, mban qëndrimin se arsyetimi dhe vendimmarrja e Komisionit, në rastin konkret, nuk gjen mbështetje në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore, në drejtim të ecurisë së procesit të rivlerësimit, në rastet kur shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës janë shkaqe të tjera të parashikuara në Kushtetutë, si dhe kur vendimmarrja merret nga juridiksione të tjera përtej atyre të rivlerësimit<sup>1</sup>.

Për Komisionerin Publik, Kushtetuta, konkretisht neni 179/b, paragrafi 3, parashikon se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

Në interpretim literal të sa më sipër, Kushtetuta e lidh fillimin e procesit të rivlerësimit për magistratët për shkak të ushtrimit të detyrës/*ex officio*, ndërsa përfundimin apo ndërprerjen e procesit me aplikimin e masave disiplinore të nenit G të aneksit të Kushtetutës, nenit 56 dhe nenit 58 të ligjit nr. 84/2016. Kushtetuta dhe ligji i rivlerësimit kalimtar nuk parashikojnë deklarinimin e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, për shkak të humbjes së statusit

<sup>1</sup> Neni 179/b, pika 7 e Kushtetutës, parashikon se: [...] Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, *krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë*. Gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit [...].

të magjistratit, pasi është dënuar me vendim penal të formës së prerë, siç është në rastin konkret, apo për shkaqe të tjera të parashikuara në Kushtetutë, në kuadër të vendimmarrjes nga juridiksione të tjera disiplinore, përtej organeve të rivlerësimit.

Komisioneri Publik vlerëson se, për efekt të procesit të rivlerësimit, janë organet e reja kushtetuese të rivlerësimit që do të vendosin përfundimisht mbi pasojat që sjellin në procesin e rivlerësimit të subjekteve, situatat faktike të humbjes së statusit dhe mbarimit të ushtrimit të detyrës nga shkaqe dhe juridiksione të tjera. Baza ligjore për vendimmarrjen e institucioneve të rivlerësimit, në drejtim të moskalimit me sukses apo të ndërprerjes së procesit, është parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, duke u kornizuar në funksion të procesit të rivlerësimit dhe në kufijtë e shkaqeve të parashikuara në procesin e rivlerësimit.

Sa më sipër, duke u qëndruar parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, duket se rasti konkret kategorizohet si *çështje e papërfunduar për efekt të juridiksionit të rivlerësimit*. Ky arsyetim, merr shkas dhe nga formulimi i pikës 8, neni 179/b, i Kushtetutës, ku ndër të tjera parashikohet se: “...Pas shpërbërjes së Komisionit, *çështjet e papërfunduara* të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor...”, ku duket të jetë i qartë dhe një kategorizim tjetër i çështjeve, që për një shkak kushtetues, siç është mbarimi i mandatit, çështjet klasifikohen si të papërfunduara nga juridiksioni i Institucioneve të rivlerësimit, duke u mundësuar organeve të tjera të drejtësisë rivlerësimin eventual të tyre, në rrethana dhe situata të ndryshme.

#### **I. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

Në përfundim të këtyre bisedimeve, Komisioneri Publik kërkon që vendimi nr. 374, datë 23.4.2021, të merret në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- *Ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke e kategorizuar procesin e rivlerësimit të z. Shkëlqim Miri si çështje të papërfunduar për efekt të juridiksionit të rivlerësimit.*

Po ashtu, Komisioneri Publik, referuar pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, ku sanksionohet se: “2. Kolegji i Apelimit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme”, kërkon që Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në arsyetimin e vendimit të tij, të orientojë Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**